



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:121841  
Datë: 10.05.2024  
Numri i dokumentit: 05669944

Ac.nr.2451/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh..... H..... nga Kaçaniku, rr. “Emin Duraku”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. A.... H..... nga Ferizaji, ndaj të paditurve Xh..... L..... nga Kaçaniku, rr. “Nevzat Qallaku”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. A..... K..... nga Prishtina rr.FAH 117 dhe I.... L.... nga Kaçaniku, rr. “Nevzad Çallaku” pa nr., me objekt kontesti lirim të paluajtshmërisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurve kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm C.nr.506/2018 të datës 26.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

**APROVOHEN** si të bazuara ankesat e të paditurve Xh.... L..... nga Kaçaniku, rr. “Nevzat Qallaku” dhe I.... L.... nga Kaçaniku, rr. “Nevzad Çallaku” pa nr, **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm C.nr.506/2018, i datës 26.10.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.506/2018, të datës 26.10.2020, ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET** si e bazuar në ligj kërkesëpapia e paditëses Sh.....H..... nga Kaçaniku, e paraqitur ndaj të paditurve Xh.....L..... dhe I..... L.... nga Kaçaniku dhe **VËRTETOHET** se të paditurit pa asnjë bazë ligjore e shfrytëzojnë si rrugë për çasje në pronën e tyre, pjesën e hapësirës prej 83 m<sup>2</sup>, të njësisë kadastrale P- 70917048-00380-1, në vendin e quajtur “Lekeji” ZK.Kaçanik, e cila evidentohet në emër të paditëses Sh..... H..... me nga 1/1 të pjesës ideale dhe obligohen të paditurit që të bëjnë lirim të paluajtshmërisë dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, në atë mënyrë që të heqin zhavorin e hedhur në parcelën kadastrale të lartcekur dhe t’ia dorëzojnë në shfrytëzim paditëses, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit me dhunë. **II. OBLIGOHEN** të paditurit që në mënyrë solidare t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë

prej 892,45 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri i parë përmes të autorizuarit të tij për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthen në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij Aktgjykimi në afatin ligjor e paditura e dytë ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi me datë 13.12.2017, kundër të paditurve për lirim të pronës.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallë së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, theksoi se në shqyrtimin kryesor të datës 26.10.2020, në cilësi të ekspertit është dëgjuar eksperti-gjeodet M..... S..... nga Kaçaniku, i cili ka deklaruar se ngastra kadastrale nr. 380-5, bazuar nga ajo çka është në terren, çasjen faktike e ka nëpërmjet ngastrës kadastrale 380-1 që është pronë e paditëses Sh..... H..... dhe se i padituri nuk mund të ketë çasje në rrugë në kahje tjetër përveç përmes ngastrës së paditëses, e që parcela në fjalë e ka një konfiguracion të pjerrët. Tutje ka shtuar se mundësitë teknike janë të shumta, por aktualisht nuk mundet me pas çasje për kyçjen në rrugë dhe ka theksuar se gjëresi ka të mjaftueshme për hapjen e rrugës nëpërmjet ngastrës së vet për kyçje në rrugën “N..... Q.....”, ku edhe sot qarkullon i padituri në të njëjtën rrugë. Lidhur me kufijtë kadastral të parcelës së të paditurit, ka deklaruar se janë krijuar në vitin 1996, pra parcela nr. 380-5, ndërsa me ndarjen e vazhdueshme që ka ndodhur të parcelës kadastrale nr. 380-1 dhe parcela kadastrale nr. 380-11, kufijtë kadastral kanë përfunduar në vitin 2007, e që destinimi aktual i parcelës 380-11 është kullosë dhe ka një pjerrtësi të theksuar, ndërsa ka potencuar që parcela kadastrale nr. 380-5 tash është e regjistruar në kadastër nr. 380-22, pasi që i padituri ndërkohë ka bërë ndarjen fizike të një pjese të kësaj parcele dhe nga kjo ndarje fizike ka marrë numër 380-22. Nga administrimi i provave të lartcekura dhe çmuarjes së tyre veç e veç dhe të gjitha së bashku gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: -Nga Certifikata pronësore me numër të lëndës 462-2017, e dt. 20.11.2017, gjykata vërtetoi faktin se kjo pronë është e evidentuar në emër të Sh..... S..... H..... me 1/1 të pjesës ideale. Sa i përket pretendimeve të palës së paditur se të paditurit i është shkaktuar akti i pengim posedimit dhe se pala e paditur së bashku me babain e tani paditëses kanë pasur marrëveshje për krijimin e servitutit fushor, një gjë e tillë nuk mund të pranohet, pasi që gjykata në këtë çështje kontestimore, ka zhvilluar procedurën sipas rregullave

për vërtetimin e cënimit të paluajtshmërisë dhe ndalimin e cënimit, për çka edhe ka qenë baza e kontestit në këtë çështje kontestimore. Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë M..... S..... nga Kaçaniku, e dt. 16.06.2020, gjykata ka konstatuar se parcela kadastrale 380-1 ZK. Kaçanik, evidentohet në emër të Sh..... S..... H....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 5904 m<sup>2</sup> dhe i padituri Xh.....L..... në vendndodhje (teren) e posedon dhe e shfrytëzon këtë pjesë të parcelës kadastrale nr. 380-1 me sipërfaqe prej 83 m<sup>2</sup>, të cilën e shfrytëzon si rrugë për kyçje në pronën e tij. Kjo pjesë e parcelës kadastrale nr. 380-1 në sipërfaqe prej 83 m<sup>2</sup>, në vendndodhje ishte e shtruar me zhavor fraksionesh të ndryshme dhe lidhej me rrugën e shtruar me kubza betoni. Bazuar nga të lartcekurat si dhe të thënat e palëve ndërgjyqëse e në veçanti deklarata e ekspertit gjeodet në seancë gjyqësore, gjykata ka vërtetuar faktin se të paditurit kanë mundësi teknike të shumta për çasje në rrugë, prandaj kalimi nëpër pronën e paditëses në sipërfaqe prej 83 m<sup>2</sup> është veprim i kundërligjshëm, pasi që i padituri pas asnjë bazë ligjore e shfrytëzon hapësirën prej 83 m<sup>2</sup> për çasje-kyçje në rrugë, gjë e cila cenon pronën e paditëses, të njëjtës ia pamundëson shfrytëzimin e lirshëm dhe të papenguar në pronën e saj, si e drejtë e cila paditëses i garantohet me kondita ligjore ndërkombëtare, bazuar në nenin 46 të Kushtetutës së Kosovës me të cilën garantohet “mbrojtja e pronës”, ashtu siç citohet në këtë dispozitë se “*E drejta e pronës është e garantuar*”, poashtu e drejta e pronës mbrohet edhe me Protokolin 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), tutje me nenin 18 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore, pronësia citohet se „*Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanrisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarërdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti*”, dhe në bazë të nenit 93 të ligjit të lartcekur, pronari mundet me padi të kërkon këthimin e sendit individualisht të caktuar, e në të cilin citohet „*Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”, e në rastin konkret me që edhe vet i padituri pohon një gjë të tillë gjatë deklaramit të tij se e shfrytëzon pjesën e hapësirës së pronës së paditëses në sipërfaqe prej 83 m<sup>2</sup> për kyçje në rrugë, çka me këto veprime i njëjti ka cenuar paluajtshmërinë e paditëses dhe për këtë e arsyet e tjera të lartcekura, gjykata edhe e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses. Gjukata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që i detyroi të paditurit që në mënyrë solidare t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 892,45 €, edhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104€, për katër seanca të mbajtur shumë prej 540€, për taksë gjyqësore shumë prej 40€ si dhe për nxjerrjen e ekspertizës nga eksperti gjeodet shumë prej 208,45€, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-ës.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjukata e Apelit nuk mund t’i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga pika 182.2, pika (n) i LPK-së, me që ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe është bërë dhe vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Duke i pasur për bazë pretendimet ankimore të palëve të paditura, gjykatës së shkallës së dytë i ka rezultuar se, me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, sa i përket pjesës arsyetuese të aktgjykimit të ankimuar,

nga kjo kuptohet se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, jo i plotë dhe kontradiktor, për faktin se të njëjtit i mungojnë elementet e nevojshme të parapara me nenin 160 parag.3 dhe 4 të LPK-së. Kjo për faktin se mënyra se si është hartuar dispozitivi i aktgjykimit dhe pastaj pjesa arsyetuese, për Gjykatën e Apelit është e paqartë mënyra e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, në raport me pjesën arsyetuese të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka identifikuar objektin kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Petitumi i padisë së datës 13.12.2017 është lirimi i parcelës me numër 00380-1 me sipërfaqe prej 5,904 m2, e cila kërkesë është parashtrur edhe në fjalën përfundimtare, pra nuk ka ndryshuar, ndërsa përmes dispozitivi i të Aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë vendos që të paditurit pa asnjë bazë juridike e shfrytëzojnë si rrugë për çasje në pronën e tyre, pjesën e hapësirës prej 83 m2 të njësisë kadastrale 00380-1 ZK Kaçanik. Pra kjo mënyrë e vendosjes është e pjeshme bazuar në kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa nuk kemi vendosje për pjesën tjetër. Gjykata e shkallës së parë nuk ka indentifikuar në mënyrë të qartë objektin kontestsuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, se kemi të bëjmë më një pjesë të parcelës apo kontestsuese është e tërë parcela. Sipas referatit të padisë, që nuk përputhet me petitumin e saj, shihet se paditësja pretendon se një pjesë e parcelës është duke u shfrytëzuar nga të paditurit pa bazë ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditësit nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 99 dhe 253 të LPK-ës, po ashtu e njejta nuk është përmirësuar gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore dhe në fund kemi në dispozitiv të Aktgjykimit, që nëse kishte me marrë formën e prerë në të ardhmen kishte me qenë i papërmbarueshëm në praktik.

Ashtu siq është përpiluar dispozitivi i parë i Aktgjykimit të atakuar është i pa përmbarueshëm në praktikë nëse njëjti kishte me marrë formën e prerë, për arsye se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ndaj të paditurve, për lirimin e një pjesë të parcelës 00380-1 në sipërfaqe prej 83 m2, ndërsa sipërfaqja e tërësishme e parcelës është 5,904 m2, pa përcaktuar masat dhe kufijt e saj, se kjo sipërfaqe nga cila pjesë e parcelës shtrihet në terren, pra në dispozitivin e parë të aktgjykimit të atakuar nuk janë shënuar përmasat dhe kufijt që më pastaj në të ardhmen të dihet me saktësi në terren se çka duhet të përmbarohet, pra të ndahet pjesa kontestuese prej tërësi së parcelës. Pra nëse i referohemi pikës I të dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, me të cilin gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses kundër të paditurve, përmes së cilit janë detyruar të paditurit që paditësit t'ia lirojnë pjesën e parcelës objekt kontesti, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, rezulton se i njëjti dispozitiv është jo i plotë dhe i papërmbarueshëm, pasi që nuk është hartuar në përputhje me nenin 160 parag.3 të LPK-së, përkatësisht nuk janë shënuar përmasat dhe kufijt e pjesës kontestuese të palëve ndërgjyqëse. Kjo për faktin se në rastet kur kërkohet lirimi i një pjesë të pronës, atëherë kërkesëpadia duhet të jetë e qartë me përmasa dhe kufij për atë pjesë, ashtu siq parashihet në dispozitën e nenit 253 të LPK-ës, ndërsa me rastin e vendosjes edhe aktgjykimi i gjykatës duhet t'i përmbaj këto të dhëna esenciale që më pastaj kur të bëhet i formës së prerë të mund të përmbarohet.

Në mënyrën se si është formuluar pika I e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është jo i plotë, i paqartë dhe i papërmbarueshëm. Në lidhje me këtë, gjykata e shkallës së parë është dashur që konform nenit 99, lidhur me nenit 102 të LPK-së, t'ia kthej në plotësim dhe rregullim padinë paditësit pas pranimit të ekspertizës gjeodezike, në mënyrë që pjesë e petitumit të padisë të jetë edhe kërkesa me përmasa dhe kufij për pjesën kontestuese, e jo vetëm sipërfaqja e saj.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljes së dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), lidhur me nenin 160 paragraf. 3, 4 dhe 5 të LPK-së, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe rivendsoje.

Nga gjitha arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkeljet e sipërcituara të cilat gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë në ri procedurë, në atë mënyrë që të ndërmerr veprime përmes të cilave do t'i eliminojë shkeljet e cekura si më lartë, por njëkohësisht duke u kujdesur edhe për çështjet e tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe në këtë kuptim duhet të vlerësojë të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët (legjitimitetin aktiv dhe pasiv)-përfaqësimin, objektin e kontestit dhe rregullsitë formale të padisë dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses. Me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesëpadinë e paditëses, gjykata e shkallës së parë, përveçse ka për detyrim që të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, ajo duhet të kujdeset për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur, atëherë domodoshmërisht është dashur të priset edhe pjesa e dispozitivit të tij, e cila ka të bëjë me shpenzimet procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos sërish në procedurën e rigjykimit.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, të eliminojë të metat e evidentuara më lartë, ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetojë gjendjen faktike, duke i vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse të cekura më lartë, si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime, si dhe në fund të vendos për kërkesëpadinë e paditësit në bazë të ligjit.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, të kërkojë nga pala paditëse që të bëjë rregullimin e padisë, përkatësisht petitumit të saj që ka të bëjë me lirimin e pronës (me përmasa dhe kufijt) në bazë të ekspertizës gjeodezike, të konsiderohet plotësimi i ekspertizës gjeodezike me këto të dhëna, e po ashtu pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse të zbatojë me përpikëri nenin 8, lidhur me nenin 160 paragraf.4 të LPK-së, përkatësisht në arsyetimin e aktgjykimit të jap të gjitha vlerësimet e nevojshme për secilën provë të administruar, cilat fakte vendimtare i ka vërtetuar me provat e administruara dhe pas vërtetimit

të gjendjes faktike, të vendos për kërkesëpadinë e paditëses në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (c) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.2451/2021, datë 08.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi